

SHTATOR

Nr . (1)	Data e regjistrimit të kërkesës (2)	Objekti (3)	Data e kthimit të përgjigjes (4)	Përgjigja(5)	Statusi i kërkesës (6)	Tarifa (7)
54.	04.09.2024	Kërkesë për informacion ne lidhje me: Sa turistë të huaj kanë vizituar Shqipërinë ne 7 muajt e parë të vitit 2024? Sa dhoma hoteli ishin të regjistruara dhe në përdorim nga turistët nga Janari deri në Korrik 2024? Sa dhoma hoteli ishin të regjistruara dhe në përdorim nga turistët për vitin 2023?	1.10.2024	Pyetje1. Sa turistë të huaj kanë vizituar Shqipërinë në 7 muajt e parë të vitit 2024: 1. Shqipërinë e kanë vizituar ne 7 muajt e parë 6.366.275 vizitorë të huaj. Për më shumë gjeni publikimin https://www.instat.gov.al/media/13791/1%C3%ABvizjet-e-shtetasve-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-korrik-2024.pdf Pyetje 2. Sa dhoma hoteli ishin të regjistruara dhe në përdorim nga turistët në Janar - Korrik 2024 2. Kjo e dhënë në lidhje me numrin e strukturave akomoduese, dhomave dhe shtretërve është vjetore nuk kemi të dhëna për 7 mujor. Pyetje 3. Sa dhoma hoteli ishin të regjistruara dhe në përdorim për vitin 2023 3. Sipas INSTAT në vitin 2023 rezultojnë 1.817 struktura akomoduese dhe te ngjashme me to; 57,778 dhoma; dhe 129,698 shtretër.	Përfunduar	0

55.	09.09.2024	1. Listën e plotë të subjekteve që kanë përfituar leje autorizimi nga Ministria për eksportin e mbetjeve të rrezikshme në vitin 2022. 2. Listën e plotë të subjekteve që kanë përfituar leje autorizimi nga Ministria për eksportin e mbetjeve në vitin 2022. 3. Listën e plotë të subjekteve që kanë përfituar leje autorizimi nga Ministria për eksportin e mbetjeve të rrezikshme në vitin 2023. 4. Listën e plotë të subjekteve që kanë përfituar leje autorizimi nga Ministria për eksportin e mbetjeve në vitin 2023. 5. Listën e plotë të subjekteve që kanë përfituar leje autorizimi nga Ministria për eksportin e mbetjeve të rrezikshme nga 1 janari 2024 – 31 gusht 2024. 6. Listën e plotë të subjekteve që kanë përfituar leje autorizimi nga Ministria për eksportin e mbetjeve nga	30.10.2024	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për periudhën 2022-2024 ka shqyrtuar dhe ka miratuar autorizimet për eksport dhe tranzit mbetjesh, si vijon: Për vitin 2022 janë miratuar 52 autorizime nga të cilat 37 për mbetje jo të rrezikshme, 3 për mbetje të rrezikshme dhe 12 për tranzit mbetjesh. Për vitin 2023 janë miratuar 56 autorizime nga të cilat 28 për mbetje jo të rrezikshme, 11 për mbetje të rrezikshme dhe 17 për tranzit mbetjesh. Për vitin 2024 janë miratuar 28 autorizime nga të cilat 19 për mbetje jo të rrezikshme, 2 për mbetje të rrezikshme dhe 7 për tranzit mbetjesh	Përfunduar	0
-----	------------	--	------------	---	------------	---

		1 janari 2024 – 31 gusht 2024.				
56.	09.09.2024	Kërkese për informacion ne lidhje me: Ju keni miratuar sipas Urdhrit 251, datë 22.08.2022, planet e mbarështimit të ekonomive pyjore “Dushku i Bulçarit”, “Gramsh-Vinë”, “Holtë-Lukovë”, “Rovë”, dhe “VidhanSkënderbegas” në Bashkinë Gramsh të cilat janë financuar nga Banka Botërore. Pas korrespondencave me Bashkinë Gramsh dhe verifikimit të dokumentacionit kemi konstatuar ndryshime të kufijve të ngastrave e nën ngastrave pyjore dhe kullosore. Po citojmë ligjin 57/2020 “Për Pyjet”, Neni 5 “Kufijtë dhe ndryshimet në fondin pyjor kombëtar”, pika 4. Ndryshime (heqje/shtesa) të sipërfaqeve nga/në fondin pyjor kombëtar bëhen me: a) miratimin e ministrit për	23.09.2024	Ne vijim te kërkesës tuaj ju bej me dije si me poshtë vijon: 1. Miratimi i planeve te mbarështimit behet bazuar ne germën (b), pika 2, neni 11, te ligjit 57/2020, date 30.4.2020, “Për pyjet” ; 2. Kufijtë, gjendja e grumbujve pyjore, masat, ndërhyrjet, objektivat dhe te tjera te dhëna apo aspekte, ndryshojnë dhe pikërisht për këtë hartohen edhe planet e reja te mbarështimit dhe inventari i tyre; 3. Ndryshimi i kufijve ne rastin konkret nuk ka si baze ligjore nenin 5, te ligjit 57/2020, por ndryshimin e funksionit/formës se qeverisjes tyre. Por këta kufij kane ndryshuar sepse ju është kthyer pronareve te ligjshëm, sipas akteve ligjore e nënligjorë për pronat dhe nuk është fushe e përgjegjësisë MTM, por e institucioneve te tjera. Ne këto raste strukturat pyjore bëjnë vetëm azhurnimin e te dhënave ne Regjistrin e Fondit Pyjor e Kullosor Kombëtar, si pasuri pyll/kullote ne pronësi private; 4. Ne lidhje me pyetjen se ku kane shkuar sipërfaqet pyjore, ato sipërfaqe janë ne pronësi private, te përfituara sipas legjislacionit përkatës për pronat.	Përfunduar	0

		sipërfaqe deri në 1 ha; b) vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqe mbi 1 ha deri në 10 ha; c) ligj të veçantë për sipërfaqe mbi 10 ha. Pas verifikimeve na rezulton se në kundërshtim me ligjin kemi ndryshime të kufijve të parcelave, specifikisht: parcela 1, parcela 2, parcela 3, parcela 4, parcela 5, parcela 6, parcela 7, parcela 8 mungon në planin e mbarështimit, po ashtu kemi ndryshim të kufijve të parcelave në të gjithë Ekonominë Pyjore “Gramsh-Vinë”. (shikoni hartat bashkëngjitur)				
57	16.09.2024	Kërkese për informacion ne lidhje me: 1. A është konstatuar sasia e eksportit prej 20 mijë tonë në subjektin *****? 2. A është konstatuar mungesa e dokumentacionit dhe autorizimi I Ministrisë së Mjedisit për eksportimin e mbetjeve të rrezikshme? 3. A ka patur komunikim agjencia Kombëtare e Mjedisit me doganën për të	30.09.2024	Në vijim të emailit tuaj ju bëjmë me dije si me poshtë vijon: Gjatë procesit të inspektimit në operatorin ***** nuk është konstatuar sasi mbetjesh në stacionin e transferimit të subjektit, por nga përfaqësuesi ligjor është pohuar eksportimi i oksidit të hekurit. Në deklaratimet e tij, përfaqësuesi ligjor ka pranuar verbalisht se ka marrë rreth 20 mijë ton oksid zinku, por nuk dispononte dhe nuk paraqiti një dokumentacion për ta verifikuar këtë sasi. Duke shqyrtuar të gjithë dokumentacionin përkatës, është konstatuar se operatori ***** nuk dispononte dokumente transferimi për mbetje jo të rrezikshme, as dokumente	Përfunduar	0

	marrë praktikën e plotë të eksporteve nga subjekti *****? 4. A ka patur miratim nga vendi pritës për këto mbetje? 5. Për cilën periudhë kohore janë kryer këto eksporte(20 mijë tonë mbetje të rrezikshme nga kompania ***)? 6. Nga të dhënat e dërguara nga ju, rezulton se subjekti ***** është gjobitur 1. 3 milionë lekë për cilën arsye? 7. Nga të dhënat e dërguara nga ju rezulton se subjekti ***** është gjobitur me 1. 5 milionë lekë pasi nuk ka një kontratë me një subjekt të licencuar për transportuar mbetje të rrezikshme. Për cilën periudhë ka mungesë kontrate? 8. Gjatë inspektimit a keni verifikuar se këto mbetje të eksportuara nga subjekti *** janë marrë pranë Subjektit ***? Nëse jo, ku i ka gjetur subjekti *** mbetjet e rrezikshme?		dorëzimi të mbetjeve të rrezikshme dhe nuk dispononte Autorizim Eksporti nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit. Ju bëjmë me dije se subjekti ***** është gjobitur me masën 1 300 000 lekë, pasi nuk dispononte dokumentacionin e nevojshëm ligjor për çfarë deklaronte. Gjithashtu, ndaj subjekti *****.a është marrë masë administrative pasi subjekti nuk ka përmbushur kushtet e lejeve të mjedisit që disponon. Inspektimi për të cilin ju interesoheni, nuk është inicuar me kërkesë të Prokurorisë, por theksojmë se Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit po bashkëpunojnë me Prokurorinë e Durrësit duke vënë në dispozicion çdo dokumentacion të kërkuar.		
--	--	--	---	--	--

		9. A e keni nisur raportin dhe gjetjet tuaja pranë Prokurorisë? 10. Inspektimi i iniciuar prej jush ka ardhur si pasojë e një kërkesë të Prokurorisë së Shkallës së Parë Durrës? 11. Cilat kompani të tjera kanë qenë të licencuara dhe kanë kryer eksport të mbetjeve të rrezikshme. Sa raste janë dhe sa është sasia e eksportuar? A kanë patur këto kompani dokumentacionin përkatës për këtë eksport?				
58.	24.09.2024	Kërkesë për informacion ne lidhje me: Cila kompani ka leje mjedisore për landfillin e mbetjeve të rrezikshme, jo radioaktive? · Si kryhet kapsulimi dhe depozitimi i mbetjeve të rrezikshme? · Cila është kompania që ofron eksportin e mbetjeve të rrezikshme jashtë vendit?		Në proces		

		· A mund të kryejnë Inceneratorët trajtimin e mbetjeve të rrezikshme? · A është ndërtuar ndonjë objekt për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme apo qendër pritëse? · Nëse po, kur dhe ku është ndërtuar godina për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme? · Nëse jo, cilat janë vendet specifike që dërgohen mbetjet e rrezikshme?				
59.	24.09.2024	Kërkese për informacion ne lidhje me: 1. Sa mbetje kimikatesh janë krijuar gjatë vitit 2020? 2. Sa mbetje të rrezikshme janë krijuar për vitin 2021 ? 3. Sa mbetje të rrezikshme janë krijuar për vitin 2022? 4. Sa mbetje të rrezikshme janë krijuar për vitin 2023?		Në proces		

		5. Sa mbetje të rrezikshme janë krijuar deri më tani për vitin 2024? 6. Sa ton vaj I përdorur është akumuluar për vitin 2020, 2021, 2022, 2023, 2024?				
60.	24.09.2024	Kërkese për informacion ne lidhje me: 1. Kërkojmë informacion lidhur me vendin ku grumbullohet apo landfillet e zhivës dhe arsenikut? 2. Ku ndodhen vend grumbullimet e Cianurit, specifiko edhe vendin? 3. Në cilat magazina mbahen në Elbasan zhiva specifiko edhe vendin? 4. Në cilat magazina mbahet arseniku specifiko edhe vendin? 5. Në cilat magazina mbahet Cianuri, specifiko edhe vendin?		Në proces		

		6. Specifiko detajisht si menaxhohen Zhiva, Arseniku dhe Cianuri dhe si kryhet magazinimi i tyre apo nëse kryhet kapsulimi?				
--	--	---	--	--	--	--

Shënim:

Regjistri përditësohet çdo muaj.

(1) Evidentohet kronologjia e kërkesave.

(2) Evidentohet nisja e shqyrtimit të kërkesës.

(3) Identifikohet lloji i kërkesës.

(4) Reflektohet afati i shqyrtimit të kërkesës dhe nëpërmjet klikimit njohja me përmbledhjen e përgjigjes.

(Të dhënat personale anonimizohen në përputhje me ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”)

(5) Ndihmon kërkesuesin për të njohur ecurinë e procesit.

(6) Evidenton vlerat monetare për dhënie të dokumentacionit në përputhje me udhëzimet përkatëse.